

TAHIR DIZDARI

HUAZIME ORIENTALIZMASH NË SHQIPET

b a l l a s h ê k a s adv. Në "Disa vëshgime mbi të folmen e Matit" (K. Ulqini, Bulet. i Uni. Sht. Shkencat shoqnore III, 1951, f. 208) me këtë vështrim: "diçka e përcaktueme, as ashtu as kështu: e la fjalën *ballashêkas* nuk e këputi, e preu fjalën pa u kuptue se ç'anë do të mernte. Kohja asht *ballashêkas* = nuk kuptohet a do të kemi kohë të mirë apo shi". Bahri Beci në "Hulumtime gjuhësore në Mat" (Buletini i sipërm II, 1963 — f. 234), në këte fjalë thotë kemi një kompozim: bashkimin e një emni me një ndajfolje, ku përftohet një tjetër ndajfolje.

Në ndryshim me dy vokale(t) dhe me elementin sufiksial adverbial të shqipes *-as*, kishte me paravue turkishten **b u l l a s h i k** (paskajori *bullashmak*): përzimë; përllyem, përdhosë; ngjollë smundje kontagjoze; enë (= *va-sellame*) etj. (Sami 319)**)

b u l l ù t — i m. para 30 vjetësh në Shq. të Mesm.: mastikë, uzo. Në tur. *bullut*, kryesisht do të thotë mjegull, por fig. i dejun, i bamë brryl (= it. *brillo*).

b i b i r ê k Në fjalorin e Gazullit 561: shtang: "njatë qi han bukën e përmbysë kupën ka me e gri Zoti *bibirek*. Ndeja gjithë ditën tue pritë *bibirek*". Nën këte fjalë dhe **b i b r a k** - e adj. lakuriq blec. curak: ndoshta fj. turq. *bi* (pa), *brak* (brakë). Për trajtën *b i b i r ê k*, cfr. tur. **b i b e h r ê** (fjalë persishte e përngjitur me parashtesën *bi-* "pa" me kuptim mohues, (v. *bi* në këtë fjalor), dhe **b e h r ê** "zotsi, njohuni" etj. kështu: i pazoti, i privuem, qitak, në zall" (Sami 828, Alus 67).

b u n x h ù k - u m. Kosovë: ruezë gatarje: it. *chichi di vetro*. **B o n x h ù k** në turk. e vjetër "lvozhgë insekti", e në të tashmen: ruezë ose kokërrza gatarje false ngjyrash të ndryshme që u vehen për smysh kuajve nëpër ullarë ose fmijve ndër kësula. Ka edhe ngjyre të zezë nga këto kokërrza, që gratë i përdorin nëpër rrobe. (Sami 323). Kjo fjalë ka hy dhe në rus. *bunçuk* "korotkoe drevko e privjazannim konskim hvostom kak simbol vlasti — u Kazaçbih atamanov, getmana" — (slovar ruskogo jazika 51).

b u r i - ja f. Veri me disim. vok., por në Jugë **bori** - ja f. 1. Vegël muzikore aerofone prej metali, së eilës kur i fryhet, nxier një za të fortë. Përdoret sidomos n'ushtri; germ. Trompete (Mey), / Kah binë këto **burija?** 2. Vegël parake me lvore pemësh të ndryshme, që përdoret **pothuej**;

* *i*-ja palatale e theksueme e turkishtes *bullashik*; në të folmen e Matit ka gjasë të ketë zbrërthe në diftongun *ei*, kështu ma së pari *bullshik* *bullshêik*, e mandej tue kalue edhe në *-ë-nazale* *bullashêk*. Përsa i përket ndrrimit fonetik *u*:a në silabë të parë (— *bullashik*: *ballashêk*) në ate të folme asht i rëndomtë ky fenomen. Siç kumtonte ma parë B. Beci (v. Bulet. Shk. Shoq. 2 — 1962 — f. 249), *o*-ja e ndodhun para rrokjes së theksueme, në shumicën e rasteve jep *a*: axhak, dallap, jargan, kanak, apanga etj. (kështu ngjet dhe në të folmen e Shkodrës — ana myslimane —, dhe t'Ulqinit: kos: kas; koronë: karonë; boll: ball etj.).

** Edhe për fjalëformimet *f u t*, *s h a m s h a i* (turq. *shemsiyê*); *siç* ja kemi pas thanë me kohë edhe gojarisht në f. 233, 34, të studimit të Becit, sh. vijimin e punimit tonë.

se në të gjitha krahinat e atdheut. 3. Gyp, tub, lëfy: buri sobe (stufe). sqolli. Cfr. *byrik*-u m. gyp i kazanit nga rrjedh rakija (Q.H., Bul. Inst. Shkenc.). Në tur. b o r u dhe b o r i, në vështrimet e sipërme dhe fig. tytë (Sami 311). Simbas Prof. Çabejt, *bori* e kanë Bogdani dhe Arb. e Italisë.

b u r i z a n -i m. dhe *borizan* (tur. *burizan*, vulg. *borazan*, me sufik. pers. — *zan* = temë e prezentit të foljes *zâden*: me i ra, me rrahë një vegël muzikore etj.). 1. Ushtar i caktuem për t'i ra burisë. "Tue i hypë gjogut n'pulla shkruet, — *Burizânen* ka urdhue: — Bje buris e t'dalë ushtria. — (Fishta). "*Burizâni* të madhe piskatë: — Tri taborre të bâhen gati", (në rreth të Pukës). 2. Ke Mey. 54, me kët kuptim ka b u r i x h i. 3. *Burizâne*—ja f. Lumë: vegël muzikore aerofone që punohet me lvore pemësh të ndryshme. 4. *Borazâne*-ja f. kurrizi i thikës, tuni (Fj. Gj. shq. 43). 5. *Borazâne*, toponim në Fushë të Krues.

b u r n u s -i m. Përmbahet në fjalorin e Leotti-it 61: mallotë; it. mantello. Arabisht *burnus* "nji lloj tallagani katërkandësh e tëpër i gjanë që bartin arabët. Nji lloj veshje e sipërme për gratë kur dalin për *teferic* jashta qytetit" (Sami 290). Simbas Lok. 30/365, huazim nga lat. *burnus*, *birras*, gr. βίρρος.

Sekr. burnus; pol. burrus; fr. bournous; portg. albornoz; it. bernusso; rus. burnu_g etj. (Mik., Lok).

b u r u l l u k -u m. 1. Berat: degërmi e bardhë që venë në krye gratë, sidomos në rasa mortesh. Rus. platok. 2. Nji lloj pëlhere e hollë, e bardhë, bartë qëmoti në katundin Paftal (Berat) për të mbulue fytyrën (si *agësllëku* në Shk.), veç syvet, (Vis. Kombit XIII f. 196). "Ti lujë shaminë, ujdís *burulluknë*.— Tre vjet në burg, sa tri ditë mu duknë" (Jugë). 3. Ke Bash. *burulluk*-u m. "napë, faqoll; it. velo del capo". 4. Në Bulet. Inst. Shkenc. (Q.H.) *burulluk*-u m. "shamija me të cilën presin fllokët e dhan drit kur qethet". Në fjalorët turkisht s'gjej gja të përngjashme. Në lidhje me *burullukun* "mbulesë e gjysmës së fytyrës (pika 2), me ramje të nazalit dental, kishte me supozue për një turkishte *burunlluk* "hundëse" (= *burun* "hundë", me sufik. = *llik*), sepse tue pasë qenë mërtisja e fytyrës për të njajtën pjesë që asht mbulue me *agësllëk* në Shk. (v. kët fjalë), del se mbulimi asht ba nga sytë e poshtë, tue përfshi hundën, gojën e faqet. Për të mërtisunit sipër syvet, ka pasë fjalë të veçantë, që në Shk. i thonë *ballicë*. Përsa u përket vështrimeve të përmbajturn në pikat 1 dhe 3, kishe me krahasue nji të përngjitur tur. b ü r ü m l i k. Në tur. *bürüm* do të thotë: palë, gja e palosme; dhe paskajori *bürümek*: me mbështjellë, me mbulue me napë, me pëlhurë (=kokën).

b u r u m l i -ja f. Në Fj. Gj. shq. 52 "vegël argjendarësh, që shërben për të kapur kollaj gjana të imta; piskër, pinzë. "Ke Busetti 57 b u r m ë l i -ja f. it. "madrevite". Cfr. tur. *burumli*: gja që sillet e përdridhet (folja *burmak*, v. *burmë*), dhe *burünlli* "gja me majuc", ose *burmalli*, nga *burma* me sufik. -lli.

Sekr. prsten *burmalija* (Mik.)

b u r x h - i m. Në Shk. e gjëti thuhet për të tregue, me parapamje. motin e stinët: për kët vjet shifen *burxhe* të këqij, do të kena thatsinë. Si duken burxhet, simjet do të kemi sène shumë të mbarë. Fig. me kuptim abstrakt: kanë ndrrue *burxhet*, s'asht ma si përpara, po dalin gjana të reja. Tur. *burç* (ar. burxh), nga lat. burgus simbas Lok. 29/362]. Cfr. dhe gr. βύργος. Mirëpo, simbas Samiut 288, fjalët *bourg* dhe *burg* të gjuhëve

të Perëndimit janë marrë nga ar. burxh. Në turkishtet me kët kuptim; pyrg kështjelle, tabe; astr. shenj i zodjakut, kostelacion (Sami po aty).

burxhàk- u m. 1. Fush'e Korçës: bot. bimë nga familja e Leguminozeve, që e mbjellin në pranverë posaçërisht për ushqimin e lopëve. *Burxhaku* kacavaret e përdridhet njani me tjetrin, asht në përgjasim të grozhlës që binë vetiut grunajevet e gardhiqevet, dhe diferencon me grashinen, tue e pasë kokërrzën pak ma të zezë. Me sonorizim të afrikatës në silabë të dytë nga tur. b u r ç à k, e njajta bimë. (Sami 308). Në Fj. gj. shq. 33, ndoshta me ramje të likuides, kemi b u x h à à k -u m. bot. (*Vicia sativa*) "bimë vjetore e livadheve, e familjes së Papilionacevet, me bishtajë të gjatë; e përdorin dhe e mbjellin për tagji e për hejë të kafshëve e të bagëtisë".

burrnót-i m. Kudo, por në Kosovë me asim. prog. *burrnút*, nga tur. *burún otú* (= *burún* "hundë" dhe *ot* "bar"). Nji hundë *burrnót*. Fig. ky nrxanës asht *burrnút*, shumë i dobët, krunde. (Fj. gj. shq. 52). Nji pisk *burrnót* (Shk.): sasi e vocërr, mikroskopike, pa randësi. "Qi un Shqyp-tarin, morë Prëlë, — Pasha at Sh'Pjetrin e Cetinës — S't'a báj as p'r'i hundë *burrnót*. — (Fishta).

Bul. *burnot* (Mey.); sekr. *burmut*, *burmuxhija*, *burmutica* (Esih 30).

buxhàk -u m., shm. *buxhaqe*: 1. Korçë: qoshe, kand, sop., skutë *Zere buxhakun*: merr vend në mindër, në kandin kryesor të votrës. E kanë këte fjalë Meyer, Weing. — 9 "Winkel", dhe Fj. gj. shq. 53. Pvb. "oxhaku *buxhak* s'bahet" (Shk., Labëri). 1 la vjet s'i gjet sivjet — Lanë *buxhaqet* shkret (Labëri). 2. Lodër fmijsht si top e kalë që luhet në Shk. 3. *Buxhaku*, emën familje. 4. *Anabuxhakthi* adv. Jugë (=skutëza e nanës? sepse tur. *anâ* "nanë" apo me *anë* shqip?) dhomat e kësaj shtëpije janë *anabuxhakthi*, nji këtu, nji atje, damas. Tur. *b u x h à k* "qoshe, kand". Bul. *buxhak*; rum. *buxhak*; pol. *budziaki* (Mik. Mey.); sekr. *buxhak* "ugao, kut" (=skutë), *Buxhak* (zemlja) "Besarabija" *buxhaklija* (Esih 29).

buxhèk -u . Jugë zool. arrç, dosëz, skirficë, bushtërz, këlysh dheu, urithi-burghth (Grilotalpa vulgaris): gjini e kandrave erthoptère; ngjyrë dheu, e fortangtë dhe trashaluqe, me çapojt e parëshëm të shkurtë e të haptë, gërmon dhe banon në galerina nëndhese dhe damton bimët. Përmbahet në fjalorët e Cord. 283 dhe te Fj. gj. shq. 53. Turkisht b ö x h e k "kandërr, insekt", dhe *ekin bõxhegi* (literal. insekt i bimës); kandrri që u tha ma sipër.

buz adv. Gjinok. : akull, fig. shumë të ftoftë. Pus'i ynë e ka ujët *buz*. Jam *buz* nga këmbët. Kam shpinen *buz* të ftohtë, të ngrirë. Tur. b u z, me të njajtat vështrime.

buzùk -u m. asim. regres. në Fj. gj. shq. 53, por në të folmen e Jugut b o z ù k . 1. Ke Meyer "Zimbel; grosse Gitarre mit sechs Draht-saiten". Në Fj. gj. shq. "kitarë e madhe me 6 tela"; qemben (Bus.) it. cembalo. 2. Korçë: vegël muzikore kordofone, në përgjasim të buligarisë me 4 deri 6 tela. Pvb. fukaraja është *bozuku* i zengjinit (kat. Beratit). "Kur të martosh t'ët vëlla, " Me dauille me zurnia. — Me *bozuk* me tambura!" (V. D.) 3. Kashë druni e lahutës; syn. kulte, grrroqe, bludë (R. Sokoli) *). Tur. b o z ù k: nji lloj tamburaje pa perde — pa pjesë të ndame për të vu gishtat kur i bihet.

Rus. *buzuk* "starini muzikalni instrument vrod e mandolini".

*) Në nji valle të Bilishtit: "Sintor, *kokëbuzuk*. — Mblidhe menden se të kump;" Ky kompozit mund të jetë përdor për të tregue përgjasimin e kokës me veglën muzikore ose me adj. turkisht *bozük* "i prishun, i çartun", silkurse në *bashibozük* "kryeçartun".

bybër - i m. Shk. dhe një pjesë e Kosovës; *bibër* Dib.; dhe me epentezë të një *r*-je. *bërbër* Tiranë, Krue (në ma të shumtat e viseve të Jugut *pipër* *), dhe në Elbas. *pypër*). Tur. *bübër*, *bibër*, nga hindishtja thotë Samiu 305 / 1. B. t. (Piper nigrum) bimë tropikale që jep kokërrza të zeza aromatike, të cilat bluhën për t'u përdorur në gjellëtore. Pvb. "mos prish një kazan jahni për pes para *piber*";". (Jugë). 2. Në Dib. thuhet *bibër i zi* për të sipërmin dhe *bibër i kuq* për specin. Edhe në Jugë përgjithësisht përdoret: *pipër i zi* dhe *pipër i kuq*. Në turkishtet: *karà bübër* për të ziun, dhe *arnavut büberi*, për specin e kuq. 3. *Bybercë*-a f. ke Busetti 763 enë e vocërr për byber; it. pepaiuola.

Sekr. biberli, bibernjaçe (Mik.)

byftàn dhe biftàn - i m. Jugë, me ndrrim të spirantit velar me atë labiodental, nga tur. *b ü h t a n* (pers. *bohtan*) Si në turkisht, kallxim i rremë që prek nderin e tjetrit; shpifje, zhgarkim, kalumni, bigoni, kallat (Bus.).

bylbyl - i m. Shkod., një pjesë e madhe e Kosovës dhe e Shq. Mes.; me palatalizim të dy zanoreve *b i l b i l* në Jugë e në Dibër; por në Jugë edhe me disimilim (*l:r*) *b i r b i l* ku dhe *b ë r b i l* nga tur. *b ü l b ü l* pers. *b o l b o l*, i njajti shpend: *Sylvia lusciniæ*: kojgush (Bash.) zog drite, zogël-a (Gaz.M.M.). / Fig. m'a ka zanin si *bylbyl*. Ndrye si *bylbyli* në kafaz. *Bylbyl* e zog hutit (në shakà, për një që piriqohet, Shk.). Ka gjuhën *bilbil*, flet bukur, s'i ngelë gjuha në gojë, s'i pushon goja. Pvb. "Nuk këndon *bilbili* kur i ve galën në kuvli" (Korçë). "Ma mirë sorrë në pullaz se *bylbyl* në kafaz" (Shk.) "E pandehu *bilbil*, po dolli thëllëzë" (Jugë). "Fillove si *birbil* dhe mbarove si gallóf" (Korçë). "*Bilbilin* e futën dhe në kafas, po vatanin e vet pelqeu" (Jugë). "Fëmitë janë *bylbylat* e shpisë" (Shk.) "*O bilbil* ta bëra benë: — Në ta gjeça dot folenë, — (Labëri). Ke Bardhi 51 *bilbil*: "kish (=qysh) do zogëla e *bilbili*, ia bië prendëvera". Arb. e Borgo Erizzo *brbyl*, dhe ke Schirò *virvilzë*-a f. (Mey. 36). 2. Vegël muzikore aerofone me trajtë dhe madhsi të ndryshme. Me i ra, me i fry *bylbylit*; me thirë me *bylbyl* (për atë të metalët që përdorin organet e rendit publik). Pvb. "I ka mëndët majë *bilbilin*" (Jugë). 3. *Bilbil*-i em. i përveç. në shumë vise të Jugut, që shkurtohet në *Bilo*.

Sekr. bulbul, biljbilj (Mik.). e simbas Mey. edhe në bul. e rum.

bylme - ja f. (me ndrrim vokalik në silabë të parë dhe me spostim akcenti) term. ndërtimi: mur shtëpije për ndamje të mbrendëshme të kthinave, me gjysëm tullë (= 12.5 cm.), dhe që përmban gjysmën e trashësisë së murit tek-tullë, 25 cm. Në turkisht *b ö l m è* (deriv. nga *b ö l m è k* "me pjestue, me copëzue; me nda, me prë etj."); zdatk që ndanë pjesët e mbrendëshme të një ndërtese.

bylyg fj. plk., me asim. prog. nga tur. *b ü l l u g*, ar. *b u l u g* "mosha e të burruemit". 1. Shqip. e Mesme: me u ba *bylyg*, i zoti i vehtes, me u ba për burrë; germ. Mannbarkeit: it. pubertà. 2. *Bylyg* e ka dhe Busetti 787: "l'età in cui le leggi permettono il matrimonio; pubertà". Po aty dhe *bylygxi*-je adj. "che è giunto all'età della pubertà, pùbere". Në Shqipni të Mesme thuhet edhe: me hy, me qenë në *bylyg*.

bylyk - u m. shm. *bylyqe*, me asim. nga tur. *b ö l ü k* (deriv. nga rranja *b ö l*, me sufik. — *ü k*, , paskajori *b ö l m e k*, v. ma sipër *bylme*). Me të njajtat vështrime që ka në turkisht: 1. *u s h t*. trupë kambësoriye, kaloriye, artileriye etj. prej 100 deri 250 ushtarësh, të komanduem

*) (fr. gr. *pop*. *pipër*; lat. *piper-eris*.

prej një jyzbashit (kapiteni). / Një *bylyk* nizamë, dy *bylyqe* asqer, një *bylyk* suvari. "Ali Qorrin me çue m'e marrë. — Me ia dhënë dy *bylyk* nizamë, — (nga kanga e Bec Patânit, qark i Shk.). 2. Turmë, grumbull: Vinë një *bylyk* me zonja. — Bëjnë llaf e muhabet" (Përmet). 3. Ndamje, pjestim: ishin nda *bylyk bylyk*, seicili taraf në vehte. 4. Ulqin: një *bylyk* ulli, një pjesë e ullishtes e përbase prej 20 deri 100 rranjë ullijsh. 5. Ke Meyer 58 edhe *bylykçim*. "udhëheqës i një turme, grumbulli njerëzish". 6. *Bylyku*, em. familje në Tiranë e Qafmollë.

Bul., sekr. buljuk; rum. buluc; (Mey.)

bylykbash -i m., shm. *bylykbashllarë* (tur. *bölükbashi* "kreu i një njisije, i një kompanije etj. Oficer me gradën e kapitenit në oxhakun e jenigerëve; kreu i një grumbulli hamajsh. Sami 322 *). 1. Shk. para 50 vjetësh, titull dhe funksion i kryetarit të një krahine, mëkambës i sundimtarit në malsinë e veriut, që emnohej prej Valiut mbi propozimin e Sergjerdës, dhe mvarej në Xhibal-dajre (=zyra e maleve, konsulto kët fjalor për bergjerde e Xhibal). *Bylykbashi* i Rrjollit, Shllakut, Temalit, Kelmendit, Postribës etj. *Bylykbashi* administronte krahinën (juridksionin e bajrakut), tue qenë i adistuem kurdoherë prej krenëve të vendit (bajraktarë, vojvodë e krenë të tjerë), dhe çdo vendim të dhanun, e zbatonte me gjobarë e djelmëni simbas dispozitave të kanunit të Lekës ose të Xhibalit. *Bylykbashllarët* zgjidhjeshin nga shtëpitë e para të qytetit të Shk. që hiqeshin (dhe ashtu konsiderohej!) se u shkante për traditë fisi . . . arti i sundimit. Pvb. "moj e bija e *bylykbashit*, kij metë vedit për mbas tashit" (Shk.). "*Bylykbash* t'vraftë buka. — Kah kujtove se t'u tuta. — Se t'i fola dy fjalë t'buta?" (Pejë). 2. Dibër, heret nen sundimin osman, titull i komandantit të gjindermarisë: "*Bilibash* me kal të bardhë. Udhë e mbarë brë Cen, bre gjalë — Pej hapsanjes kour ke dalë?". 3. Në rapsoditë e Mujit e Halilit, ndeshet si mbiem. a titull: *Bylykbash*-e Muji. Po në kët cikël figuron dhe një personazh tjetër me të njëjtin titull: "He shka tha Maliq *Bylykbashi*: — A merr vesht ti Çete-bash-e Muja, —" (Kosovë). 4. *Bylykbyshi* (=Faik) n'Elbas., dhe në Jugë *Belibashi*, *Bilibashi*, emna familjesh.

sekr. buljubasha "zapovjednik vojnika", buljubashin, buljubashnica (Esih 29). Rum. bulubasha Führer "garde-hauptmann" jetzt: "Zigeunerhauptmann" (Lok.) Me kët zbritje titulli e rangu ka qenë katandisë dhe çeribashi në Shk. (v. ciribash në kët fjalor).

byrazër -i m. dhe *birazër* Jugë. Shq. Mesme; *bilazër* Malsi e Dib-rës; *birazël*, rreth i Krues. Me këta ndryshime vokalike e konsonantike, nga tur. *biradër* "vëlla; mik", dhe kjo nga pers. *beradër* "vëlla". Në shqipet: 1. Vëlla babe e nane; vëllam, vëlla në tënzonë, probatin (me metat, nga serb. pobratim); / Me u zënë *birazera*, me u ba vëllam me një bashkëmoshatar, tue i pi gjakun shoqishoqit. "Kadri Ndrojaku paska thënë: — Si e kërkoja ashtu m'a banë — *Birazera* që paskan qanë" (nga kanga e Ali Qinamit, Krue). "Me u dhënë ndëmen (=ndihmën) grave t'veja — *Birazërat* e kumarija — (nga një vajtim në Mirditë). 2. *Birazeri*, em. familje. 3. *Byrazerë*-a f. Jugë: motër, motërmë, probateshë.

Sekr. burazer (Mey.): Burazeroviq, em. familje në Podgoricë.

byrde -ja f. 1. Shk. rrexë fytyre e zezë, me të cilën gratë mysli-mane mbulojshin fytyrën kur pat fillue me u përdor çarçafi i zi, mbas hyrjetit; syn. peçe; 2. Mbulesë e leshtë, me të cilën mbulojnë vithet e

*) Për këtë fjalë ke Lok. 22/363 : "Kompaniechef, vor. den Tanzimat offizier des tk. heeres, der für die öffentliche Sicherheit verantwortlich war".

kalit të shalës; vithanik, paravithe, bythëzë (Fj. gj. shq. . 54); 3. Ke Meyer 58 *byrdë*-a f. edhe "vêtement en étoffe rayée de deux couleurs"(?). 4. Në turkishtet b u r d è (ar. (b u r d è) "nji lloj sipërveshje, hërkaje e qëmotëshme që barin arabët" (Kamusi osmani II, 240, Sami 288).

byrëk - u m. shm. *byréqe*, Jugë, Shq. Mes.; *birëk* Dibër, Krue; *bu-rëk* Gjinok.; *berek* Tir. (tur. b ö r è k, nga folja *burnak* "me dredhë, me rrotullue" Sami 309) 1. Pvb. "Di dhe nëna të bëjë *byrek*, po ku është *gjalpët*". "Mos i zbulo petët *byrekut*, se i duken lakrat" (Jugë). 2. *Byrek sheqeri*-i m. Skrapar: ambëlsinë si gurabijata e Shk. "brum i zanun me të-lyen të shkrimë, me sasinë e duhun të miellit të grujtë dhe të sheqerit. 3. *Byrek me sheqer* në katunde të Shqip. Mesme që në rreth të Kruesit thonë *pupriç*-i, dhe në Topojan (Kukës) *ndërpec*-i (= ndër petës). 4. *Bashkimi ka b u r a k*-u: nji farë laknori i gatuem me petë e groshë.

Sekr. *burek* "vrsta pite s mesom" (Bakot. 80).

byryllfi - ja f. Shk. e gjeti para 60 vjetësh, me disim. vokalik të trefishtë, me sinkopë në -j-, dhe me desonorizim të dentalit në silabë të katërt, nga tur. b u y u r u l l d ü "u urdhnuë" (vete e tretë e aoristit të fol. refl. *buyurullmak* "me u urdhnuë", me infiksin -ull- në foljen *buyurmak* "me urdhnuë", tema *buyur* "urdhno") 1. Ashtu si në turkisht. urdhën i haptë me shkresë që u lëshohej në dorë t'interesuemeve nga Valiu ose nga ndonjë mëkëmbës i tij. 2. Ke Leotti 59 *bujurdi*-ja f. . urdhën, dekret" *)

Sekr. *bujurudija* "vezirova naredba"; *bujruntija* "zapovjedno pismo"; *burantija* "povijest ili naredha Pashe, Vezira, zemaljskog glavara" (Esih 29, 30); rum. *bujurdiu*, *bujurultiu*, *bujurdi*, *bujurdisi*; pol. *bujurdum* (Mik).

byrynxyk - u m., ambigene, po aty dhe *byrynxyke*-ja f. Jugë; *byrynxyk*-u Tiranë; dhe në Gjakovë me disim. të dyfishtë vokalik *berenxyk*-e adj. 1. Fije e hollë mëndafshi; pëlhurë e hollë e mëndafshit. (Fj. gj. shq. 54) 2. Në Tiranë: fije mëndafshi e dredhun ma hollë se *ani*. Pvb. "dy budallaj këpusin nji litar; nji i mendshëm e nji budallà, s'un këpusin nji fije *byrynxyk*". 3. Në Gjakovë, adj. këmishë *berenxyke*, e mëndafshit, e hollë, që punohet në vend, (në Gjinok. *birinxyk* Cfr. "étouffe légère et transparente de soie" (Kelekian 284); "Leichter, durchsichtiger Seiden — oder Leinenstoff" (Lok. 38/367). Edhe në Jugë si adj. por në rasë fig. "O sevda ku m'u kolise; Me dy sisa *byrynxyke*" (V.D.). 4. Në jugë edhe me alternim r : z në silabë të dytë: "O moj linjë *byzynxyke*. — Më thanë që punon ndryshe; — (B. Sh.). Në turkishte *bürünxyk* dhe *bürünxyk* "fije e fshikzës së mëndafshit; mëndafsh bruto; pëlhurë e punueme nga i tillë mëndafsh"; dhe *bürünxyk* (në këte rasë me nazalin labial -m- në silabë të dytë në vend t'atij dental në krahasim me dy të parat) "gja e dredhun në trajtë lāmshi" (Sami 311). **)

Sekr. *burunxyk* "tanko bijelo svileno platno; koprena" *burunxykli* "od *burunxyka*" (Esih 30); rum. *burumxyk*, *burungiuc*. *barangic*; pol. *burunczuk* (Mik., Lok).

*) Në turkishtet si perfekt *buyurdü* "urdhnoj" i fol. tr. *buyurmak*, ashtu *buyurullu* "u urdhnuë" i refl. *buyurullmak* (si u tha ma sipër), përdoren njësoj e me të njëjtat vështirime. (Sami 335).

**) Lokotsch 30/367, e lidh me tur. b u r ü n "hundë" (?). Kishe me mendue për radik. *bür*, nga ku ft. *bürümek* "me mbështjellë; me rrethekue etj.", dhe fint. *büünmek* (me infiksin -n-) "me u mbulue, me u mērtisë, me u mbështjellë, të cilat ndoshta kanë dhanë respektivisht *bürümahék*, *bürünzhék*, *bürünxyk*, e ndodhta me sufik. diminut. -*xyk*, -*xyk*.

byshki - ja f. 1. Shk. (ana myslimane): vegël prefse për lëkura që përdorin vetëm saraçët. Asht në formë gjysmë rrethi me një dorëz druri përsipër. 2. Te Cord 709 (it. — shqip), përmbahet në trajtën e plotë turke, **biçki** me kuptim "thikë këpucarësh"; Në tur. **biçki** (radik. **biç.** me sufik. **-ki?**) "sharrë e madhe".

Sekr. **biçkija** "cipalarska britva" (Bakotiq 58).

bytevi adv. Shk. me labializim të palatinës në rrokje të parë, por në Dib. vetëm me diftongim idiomatik në zanoren e fundit **bitéví**, nga tur. **bitévi**, në të njëjtin kuptim si në shqip: krejt, shqim, gjithmbarë, unji, tunji, fund e krye, krejtësisht, tungjin (Kosovë), inë e tëm (Prezë); E bleu hambarin me misër, si kje, *bytevi*. Çuen popullin angarije, *bytevi*, pa asnji përjashtim. "T'ap ogiçt me gjith kumonë. — Dy gerushët t'i fali ty. — Dyqind copa *bytevi*" (M. Gj., Vis. e Kombit III).

Sekr. *bitevija*: pa on baca kaplje bitevija (Mik.); "shto god samotvorno, jednostavno" (Esih 28).

bytyn adv. Shk., Jugë, Kosovë, por në Dib. e Kukës tue palatalizue të dyja *y-të*, **bitin**, ku dhe me labializim të nazalit dental fundorë **bitim**, nga tur. **bütün**, me të njëjtin kuptim si në shqip 1. Krejt, të tanë, shqim; mbarë, unji; njajze (Gaz); germ. ganz. / Erdhën si kjenë, *bytyn*. Sahat e qostek, *bytyn* flori: krejt prej ari. Tirana: ishin *bytyn*, të gjithë. Nji pjesë e Kosovës: "qysh po jeni, a jeni *bytyn?*"; nji mënyrë pyetje në të përshndetun: "a jeni shëndoshë që të gjithë". Nusët e Delvinës, — *Bytyn* lule linjës, — (rreth i Përmetit). "Paske strenglat *bitim* filxhana filxhana. — M'ò t'venë mendja, oj lule, se m'je ke nânâ (Kukës). 2. Në nji rapsodi të Mujit, *bytüm*: "Edhe qiella po veton, *Bytum* rruga zjarm po qet. — *Bytüm* bari flak po ndezet. — *Bytum* dushku n'tokë po bje". 3. Ke "Hanko Halla" e A. Asllanit, me apokopë: "Përmbi shala *byt* sadefe — Të punuara në gjergjefe — E përsjellë me dyzet defe" 4 Me vështrimin: tepkë, kokë e këmbë, toidhjo, rrukulli (Dukaj). *Bytyn*. i ati në vend: krejt, and e kand si i ati, i kish këputë kiyet (së gjami).

Sekr. **butun**, **butom**, **butum**, **buzbutum** (me prefik. superlat. të turkishtes *lüs-* T.D.) — Mey.. Esih.

byzëxhëk - u m. dhe **bezëxhëk** 1. Shk., para 50 vjetsh fjalë popullore; e përdorshin ma tepër nxansit e mejtepeve (ana myslimane): copa letrash me ngjyra të ndryshme e të ndritëshme, me piksimë lulësh, të preme e të dhambzueme me gërshanë në gjithfarë trajtash që vesheshin me andje midis fletëve të librave. *Byzëxhëku* kryesisht shërbente si qokë për të tregue vendin se ku kish ngelë mësimi (=dersi, sabahi) në supare e tefterë, por në nji kohë, si mjet zbukurimi e stolije, ishte edhe objekt këmbimesh në mes të nxanësve. Kësaj stolize qokë-mësimi, në Dibër të Madhe i kanë thanë **xhili xhik** (edhe purulinkë); në Tiranë **dyllynxhëk**; në Krue e Prezë **drexhëk**; në Vlonë **durexhëk**; në Pejë **dura xhëk**; në Margallëç **purtexhëk**; në Paramithi **kurtuxhëk**; në Korçë **texhëk**. Të tërhek vëmendjen se të gjitha këta sinonime përfundojnë me dizinencat turkisht — **xhek**, — **xhik**, **xhak**, diku me funksion diminut. e vetzeg., e diku si mbaresë e vetës së tretë të futurit. Për *byzëxhëk* e *bezëxhëkun* e Shk., kishë me krabasue tur. **bezën** "zbukurim, stoli" (folja *bezëmëk* "me ormisë, me zbukurue" — Sami 292), me mbrapshitesën diminut. vezeg. -

xhik në të folmen e Shk. me ramje të nazalit dental në silabë të dytë: *bezenxhëk* dhe *bezenxhik*. Janë për t'u pasë parasysh dhe *bezen çiqegi* "lule stoliqe" ose një *buz çiqegi*, literalisht "lule akulli" (por ke Kelekjan 285 fr. "mésemryantheme"). *Xhilihik* i Dibrës, them se mund të jetë një çoroditje e turkishtes *gielinxhik** "nusëz; lulkuq, lule nuse" (fr. coquelicot, Alus 235). *Dylynxhik* i Tiranës, të jetë thue një tjetër çfisnim i tur. *gielinxhik*? Me këtë, ofr. dhe tur. *d ü l e n g i e ç* "çerdhukul" (Sami 633). *Durexhëk* i Vlonës, *derexhëk* i Krues, me format metafonike të pësueme, ka përkueshmëni të spjegohen me *duraxhak*-un e gjallë të Pejës, për të tregue vendin se ku ka ngelë, ku ka qindrue mësimi. Në turkisht *d u r a x h à k* "do të qëndrojë, do të ngeli", asht vetë e tretë e futurit të foljes *durmak* "me qëndrue, me ngelë, me u ndalë etj". Për *kurtexhëk* të vete mendja për *kurt çiqegi* "lule ujku"; për *kuturxhik* "diametër i vogël"? *Texhëk* i Korçës, të jetë thue me aferezë një *ò t e x h è k* itur. = "do të këndojë ((shpendi"? Paskajori *ò t m e k* "me këndue shpendi — bylbyli, gjeli —, me i frye një vegle muzikore aerofone etj." (Sami 187).

cangadhe - j a f. 1. Dele a dhi që ka mbetur pa qengj a pa keç dhe që mbahet për qumësht; enjë. (Fj. gj. shq. 54). 2. Në një shkrim të Sh. Musaraj (Nandori 5—1960 — f. 129), me likuide velare në rrokje të tretë e *c a n g a l l e*. 3. Në tur. *ç a n g à l l* (me afrikatën palato alveolare në krye të fjalës) "kingj, që tue i pasë ngordhë e ama, përgjijet prej një deleje tjetër. (Sami 504).

ciribash - i m. Shk. e Tir., por në Jugë, tue iu përmbajtë trajtës turke (me afrikatën palato-alveolare në ballë të fjalës dhe me zanoren që e pason), *ç e r i b i s h*, dhe *q e r i b à s h*. 1. Në Shk. e Tir. deri para 45 vjetësh, kryeplak i mëhallës së madhe (sot "Lirija" në Shk.), dmth. i magjypvet. Në Gjinok. *Çeribashi*, em. i një familje. 12. Në tur. *ç e r i b a s h i* (nga *çeri* "ushtar, i armatosun, luftëtar", në të saktën "gjallë, me shpirtë", dhe *bash* "krye"); dhe dikur titull për kryekomandanin e ushtrive ndihmëtare etj. rangë të nalta, por së fundi vetëm për kreun ose kryetarin e evgjitëvet. (Sami 510).

Sekr. *ceribashe*, to su zapovjednici, filurxhija i druge pomoqne vojske. (Esih 31), por ke Bakotiq 1340 "ciganski stareshina".

çair — i em. dhe *çaire-ja* ef. Jugë; me metat. dhe me ndërrim theksi *çarje* - a ef. Shqip. Mesme; *çajre-ja* Fj. gj. shq. 61 v.; dhe me një — h - epentetike *çahir-i* em. Fj. rus. shqip 70. Turk *ç a y i r* me të njajtin kuptim: 1. tokë me barë që e kosisin herë mbas here, ose që ia lëshojnë bagëtisë për të kullot; livadh, ograçe, lëpishtë (Gaz.). Prov. E ka ngrënë *çairen*. Jugë (= e ka hangër livadhin. Sh.). "Rroge, stome, brija e *çajre* — Plym me d'dekun e të mbetur". (F.) "Nepër *çarje* t'barit t'njomë — Un ngas qetë e ti hudh farë — Moj Matjânj' e vogël-o (Bal-Tiranë). 2. Ke *Çarjet*, në periferi t'Elbas. *Çarja* e Gjinales, *Çarja* e Shënjinut në periferi të Tiranës.

Bulg. *çair*; skr. *çaira*, *çajir*, *çairishte*; rus. rum. *ceair* 'Pferdeweide (-kullojë kuajsh); pol. *czair* (Mik. Mey., Es.).

çaj - i em. Jugë: *çajë* — a ef. Veri. Turk. *çay*, kinez, *cha*, "çaj", *cha-ye* "gjeth i bimës së çajit" (Sami 505 dhe Lok.) (Thea chinensis); *Çaj mali*: shkurre e vendeve tona, fletët e së cilës i përdorin si gjeth çaji; *sidoritis scardica*. / Servis, takam, filxhan *çaji*. *Çajnik-u* em. Jugë: ibrik çaji; Polon. *czajnik*.

*) Fortimi i guturalit prepalatal n'afrikatën -xh- asht i rëndomtë në idiomen e Dibrës së Madhe: *gja*: *xha*; *gja*: *xhak*, *gjallë*: *xhallë* etj.

Bulg. skr. rus. çek. çaj (Mik. Lok.); sekr. çaj, çajnik (Bak. 1349).

çak. Në turk. çë me, deri në . . Sami 499 vv). Krhs. "Çak prej Hotit tue zanë filli — Dër ku piqet buka m'dilli" (F.)

Sekr. *ç a k* adv. (od turski çak) prilog kojim se jaçe podvlaçi: 1. daljina do koje ili od koje se neshto prostire: çak iz Amerike; çak do Carigrada; 2. Duljina vremena; çak do kraja idugje godine; 3. Zamashitost neke radnje; çak po cenu çalog svog imanja. (Bakotiq 1349).

çakall i- i em. shm. *çakâj, çakêj*, zoll. Canis aureus. Turk. *çakâll* nga pers. *shâgal* (Sami 512). dhe kjo me sanskr. srgâla (Lok. 153-1929). Fig. lehin si *çakâjt*. Prov. ara në malt s'ke, dava me *çakêj* pse bën? (Jugë). "Ma mirë me të hangër ujku se *çakalli* (Shk.). Uku, uku, po *çakalli* ban kërدينë (tue ulëritë— Shqip. Mesme). *Çakallit* lëshoi ukun (Elb.). M'te *çakajt* qi me ba darsëm: — Aj, qi aq trim m'mbahej dikur!" (F.). 2. Me-halla e *Çakajve* emën i një nenlagjeje në Rus të Vogël — Shk.).

Çakallosur (i, e) adj. Jugë: njeri i prishun, palo burrë.

Nga turko-pers. kjo fjalë ka marrë të përhapun gadi në të shumtat e gjuhëve të Perëndimit (Zingarelli 1399; Lok. 153-1929). Bulg. skr. çakal, çagalj; rum. ceacal dhe gr. (Mey.).

Rus. çakal, shakal; pol. szakal; çek. shakal. (Lok.).

çakçirët - t emshm. turk. *çakshir* 'lloj shallvarësh të gjatë prej kumashi të hollë. (Sami 499). Krhs. dhe pers. *çakçur*: shirokie sharováry (Persid. rus. slov. 160). Në Shk., Kosovë e ngjeti: pjesë veshje për burra që mbulon trupin prej brezit e deri në trinë të kambës dhe vishen përmbi t'linta. Çakçirët, si veshje e ngushtë e përputhun për trup, në përgjithësi janë prej shajaku ngjyrë të bardhë dhe të zezë (tue përjashtue disa shtëpija të para në Shk. që para 30 vjetësh i patën sajue prej cohe për dallim e kreni) me gajtana të zes të dendun ose ma të pakët simbas krahinave dhe të kushteve shoqnore t'atij që i veshte. *Çakçirët* bajnë pjesë në petkun kombëtar të Veriut sidomos, dhe janë bartë e vazhdojnë të barten deri diku prej mysli-manëve të qytetit të Shk., prej malsorëve të krejt qarkut, prej mbarë krahinave të Kosovës, të Lumës dhe malsinave të Dibrës (këtu me gji ma të gjana). *Çakçir* shajaku të bardhë, larue me spik të zi; me spik ari (dikur për femijë Shk.); syn. tirqë, xhidikë, kofsharë; "Veshë e mbathë si kapidana — Me çakçirë e me fistana. Me tagana e shejshana", (F.).

Skr. çakshire, çakshiretine, çakshirice; rum. ceakshiri; rus. çakçiry, çikçiry, pol. czechozery. (Mik., Es., Lok.).

Çakëll - i em. Jugë— Si në turk. *çakill* : 1. Guraleca të prun kah e rumbullakta, ngjyrash të ndryshme, të përhamë nga copëzat e shkambijve që i merr rrekeja dhe i shkapërderdh nëpër proje e lumej; zall, zhuri. *Çakëll* për të shtrua rrugët (Fj. gj. shq. 61), e sidomos për rrugëzat nëpër lulishte. 2. Gur i unorit (Berat). 3. Mur rrethues, që është ngritun vetëm në gurë, pa baltë ose llaç. (Devoll, J. Gjinari).

çakërdis ft. Jugë. Shpërndaj, largoj; çakërdisë, marr sy e iki, nuk më sheh njeri se nga shkoj; m'u çakërdis mendja, m'u prish mendja; fig. u çakërdis, u marros (Fj. gj. shq. 61). Më zuri gjumi dhe s'pashë nga m'u çakërdisë dhinë që i kisha nxjerrë për të kullotur. Vete të shikoj dhinë nga janë çakërdisur (Korçë). Edhe te Noli: shpërndaj, shkapërderdh: "... përmbyste, shtëpitë, çakërdiste hergjeletë . . .". dyke dërmuar ushtëira, dyke çakërdisur flota e . . ." (Don Kishot 185, Noli). "se tani duhet të gris robot, të çakërdis armët . . ." (idem 189). 2. Adj. Ishte bërë si i çakërdisur. Me syt e çakërdisur, me sytë të trentë, të prishun;

Që nga të parët duket si i *çakërdisur*, i tërhusun, i xhindosun. It. aspetto sformato, impazzito. "Çakërdisur, batërdisur, — Përpëlitur dhe zalisur, — Noli). 3. Në turk. nuk ka subs. deriv. *çakirdi* as edhe një folje *çakirmak çakirdamak*. Përkueshëm dhe me vështrimet, ndoshta kemi të bajmë me një metat. në shqip të turk. *kaçirmak* (n'analogji me rasi të tjera: karshtis: shkartis, etj.), që don të thotë: me ba që t'aratiset; me të dalë nga dora një gja; me *kaçërdisë* një femën; me falitë mendësh; me kalue tinzisht një mall për t'i u shmangë tagrit doganor, etj. (Sami 1018). Cfr. dhe *çakërr* ma poshtë.

çakërqëf adv. 1. Jugë: i pimë në një farë mase, i bamë në qejf sa mos me u rrëzue, gjysmë i pimë; fr. grisé. — Kërkonj pra mezin, Jetën *çakër-qëf*: — As that' as qull, po lagur lehtë larë". (Rub. O. Kaj., Noli). 2. Në turk. *çakir-keyif* dhe *çakir-keyfi*, nga turk. *çakir* 'venë' (çagataisht çagir), dhe *keif*, me të njajtin veshtrim si në shqip. (Sami 499).

Sekr. *çarka* qeif (Esik).

çakër - e adj. 1. I vëngërt, vangosh, shakshi, syll, *Syçakërr* (Folklor I.), që nuk i shofin syt në një drejtim. *Çakërr* nga syri (Korçë). E ka dhe Fj. gj. shq. 81. It. strabico.

2. *Çakërr-i* em. dhe *çakërre-ja* ef. ka dhe lopë me brina përpjetë (kat. e Peqinit). 3. *Çakar-i* em., *çakëricë-a* ef. dash e dele me gjysmën e fytyrës të bardhë e gjysmën të zezë (fshatra të Pejës). 4. *Çakërit* ft. hap syt shumë, zgurdulloj sytë. (Fj. gj. shq. 61). e Hosteni: *çakëritëte* sytë. . Në turk; *çakër* ngjyrë e përhimë e vizueme me të kaltërt: *çakir göz* — sy-kaltërt-*çakir pençè* (= këthetër) — që s'lëshon atë që shtjen në dorë, që përfi. ton prej gjithçkaje, egoist; një farë rose me krahë, të laracuem, etj. (Sami 499). Skr. çakar; rum. çakar, çakarlic (Mik., Es.).

çaki - ja ef. Brisk xhepi, sojak, biçak (Fj. gj. shq. ; 61). Turk. çaki e njehta vegël.

Skr. *çakija* (Esih, 31)

çali - ja, ef. 1. Lumë: emën i një bime që u veht deleve për më-sysh. 2. *Ferrë çalije* (Gest.): bar i idhtë, bobokuqe (Libohovë), garcafe^c (Shëngjergj), lulekuqe (Peshtan), etj. Rus. Iglica obiknovennaia; germ. Stechender Mausedorn; it. pungitopo (Drurët dhe shkurret e Shqipërisë — Mitrushi). 3. Simbas Miklos. në rum *çaliu* Gebüsch (=kaçubë). 4. Në turk. *ç a l l i*, bimë midis drus dhe barit, ma të shumtën me ferrëca nga ku dhe *çalli-kushu* — zog ferr: cicamiu, çerri, ferrc. Krhs. dhe pers. *ç a l* (Persid. rus. slov. 161).

çallak - e adj. Shkod. i zhdërvjelltë, i shkathtë, i shpejtë në lëvizje në lidhje me të punë e tregti, i gjallë, i virgjilt. Në turk. *çallak* nga pers. *çalak*, me të njajtin veshtrim (Sami 501).

çallëk - e adj. Te Bashkimi: dijekeq, kopil; Në Turk. *çallik*, (çall+ik, folja çallmàk); i pjerrun në njanën anë, shtrembnuem (= gojet), shtypun (= hundësh), prishun, xbé (=ngyret), thyem (kah mendja, budalià etj. (Sami 503).

çallaböt — i em. Bot. Bimë që rritet nëpër të lashta dhe në misroret. *Çallabotin* e harrim. (Kurvelesh = Q. Haxhihasani). Në kamuset s'gjejë një fjalë koresponduese. Në turk. e vjetër *Çallap* dhe *Çelipa* i thonë Perëndisë, dhe *ot*, bar. Unë mendoj për një kompozit *çallab + otu* = bar Perëndije,. Krhs. *burrnot*, *semizöt*, *ballköt*, etj. Sh. këtu — ot.

çallapatis ft. 1. I prish hekurin rrobes, e tutloj, e zhubros, e rruadh. (Fj. gj. shq. 61) 2. *Çallapatis*, *çajapatis*: me shpifë, me i u zhgarkue kujt. *Çajapati-ja* ef. mendim i keq në Pjana, Siqeli. gr. *τσαλαπατώ* me

shkelë, me shtypë, me ndrydhë me kambë. Simbas Mey.443, nga adv. turk. *çallà* 'tue rrafë'. Në turk. *çallà* në precedim të një subs. ka kuptim t'eksagjerimit, të forcës, të pandërprenjes në një veprim : *çallà killiç* : tue vringllue shpaten pa pra ; *çallà kirbaç* : tue sjellë me kopaqe pa reshtun ; *çallà kalem yazmâk* : tue shkruie shpejt e pa ndërpreme etj. (Sami 501 ; Alus 110).

çallmë - a ef., me ndërrim theksi nga turk. *çallmâ* em. derivat nga radik. *çall*, paskajori *çallmâk* që kaloj sipër : 1. Pëlhurë, napë e bardhë, e blertë " e zezë ose e verdhë, që rrotullohet disa herë rreth kësulës. *Çallma* asht pjesë kryesore e petkut fetar të klerikëve myslimanë, dhe përban një, shenjë dallimi për sektet dhe pak a shumë për ranget e ndryshme. *Çallmen* ngjyre së bardhë dhe atë si në të kaltërt, e venë hoxhallarët (synnitët) - atë të blertën, etnit bektashit ; të zezën, shehlerët e shumë sekteve alevi- jan, si Rifai, Halveti, etj., dhe ajo e verdha me një farë qindisje, deri para 40 vjetësh, ka qenë dallesë për haxhitë që kryjshin pelegrinazhin e Qabes në Mekë. Para 50 vjetësh, në kremtet zyrtare, mytit dhe kaditë, rrotulloj- shin çallmen me një mbështjellëse të gjanë t'artë. Syn. sarëk : "Mje sa Turku, për bri tejet, - (Cari Knjaz Nikollës) : Dredhun çallmen m'vetull t'synit, (F.) 2. Çallmen e bardhë prej faqelli, deri tashti vonë, e kanë pas bartë dhe banorët e disa krahinave malore të Veriut, si Këlmendi. Postriba, si dhe Rugova e Pejës, etj.

Bulg. skr. rum., rus. çalma ; ung. çalmadar 'nji rodë zogu' (Mey. Es. Lok.).

Çam - i em. bot. 1. Breu, bredh, borigë (Weig.), dru e pishës (kat. Tiranës). Ke Mayer 444 edhe "Harz" (=rrëshinë). *Çam i bardhë* "abies pectinata" (Cord. 284 v). "Thëllëz'e malit t'çamit, - Delja bejkë e çobanit" (V. e Detit). 2. *Çam ishite* - ja ef. bredhishtë ; 3. *Çamtë* (i,e) etj. prej çamit, prej bredhit (Fj.gj. shq. 62) (turk. çam, "bredh, pishë").

Sekr. çam 'jela ; smrça', Çamovina (Bakot. 1350) ; bulg. çam ; skr. çamovina, çamuga ; rum. ceam (Mey., Es., Lok.).

çanak - u em. shm. — ë, *çanàqe*, nga turk. *çanak*, me të njajtin kuptim : 1. Enë e thellë prej baltet, që vlen për të shti gjellë, qumësht, kos, e sidomos për të përsheshur në të ; misur (Koçë), kalanicë (Kosovë), mashtrëg-u (Arb. e ishujve të Greqisë) ; mashtrëkë (Bashk.). Ka dhe çanak prej druni, bludë.

"Pse më dhë nenë larg në Myzeqë? - Sahan s'kidhin, çanak prej balte, (Jugë). *Çanaku* (= Todi) emën familje.

2. *Çanaklëpirës-e* adj. Jugë, puthadore.

Bulg. çanak ; skr. çanak, çançiq, çançina ; rum. ceanac. cenac (Mey. Es. Lok.).

çapaçul - i m. Njeri i vogël e pa randësi, që nuk përfillet. (Fj.gj. shq. 62) "Jo asht si *çapaçul* pa tru në kokë - e kot si kot ban hije përmb¹ tokë" (Hosteni 13 - 1960 -). Në tur. *çapaçul* 'i pazoti, i çrregullt, Biçimséz ; zhelan" (S. M. Alus 113).

çapàre - t fsh. m., me ramje të likuides velare në rrokje të parë dhe me ndërrim theksi, nga tur. *çallpara*. dhe kjo nga pers *çarparé* - Sami 501 (ë përbame nga çar "kater", dhe parë "cope" T.D.). 1. Si në turkisht, dy copëza të rrumbullakta e të rrasikta prej metali, fildishi ose shimshiri, që të mbajtuna lidhun në gishtat e duarve, përpiqen me kadençë dhe ashtu lëshojnë at tingull, me të cilin shoqnohen hapat ose lëvizjet e disa kërcimeve popullore. 2. Simbas R. Sokolit (Bulet. Ins. Shk. 4,

1954, f. 120), vegël idiofone e punueme në metal. Ka trajtën e dy disqeve të ngurtë (konkav), të cilët lidhen në gishtat e duarve. Kur i rrahin shoq me shoq, këta dy disqe qesin një tingull argjentin. Sh. dhe Fj. gj. shq. 62. Siç shifet, kuptimisht këtu kemi të bajmë me dy vegla të ndryshme, njana prej të cilave kapet në dy rrypa të mesit dhe asht e madhe sa një pjatë, tjetra lidhet ndër gishtat dhe asht sa një kupë e vogël. Aq ma fort kur njana përdoret në bandë e tjetra ndër kërcime. Në Shk. disqeve që përdoren në bandë u thonë *zile, zyle*. Po me këtë vështrim edhe në turk. z i l. Si më kumtoj gojarisht J. Gjinari, në Berat u thonë *ahinga* (ndoshta onomatop).

Bul. çampari; rum. gesmpara, geambara (Mey., Bok); sekr. çampare "glazbalo sa praporcima" (Esih 31).

çapërtisë vb. (me u—) 1. Shk. me u tërhuse, me u ndërkrue, me u trumhaë, me u djemnuë, me u çartallue; it. spiritarsi, divenir furioso / S'di'te ku ishte, ishte *çapërtisë mendësh* prej smundjes. M'u *çapërtis* gjumi e s'mujta me fjetë gjith natën. Sa vjen e *çapërtiset* ma zi. Adj. ban si i *çapërtisun*, i tërhusun, si i luejtun mendsh. 2. Ç a p a r o s. Tiranë, me të njajtin veshtrim. Në tur. *çaprashmâk* "me u kryzue, me u ngërthye" (Sami 493, Alus 113). Se mos asht edhe një sajim i mbrendëshëm në folje nga *çapraz?* (v. ma poshtë këte fjalë).

çapkën - emf., adj. Jugë: ç a p k ù n Veri, nga tur. ç a p k i n me të njajtat vështrime: 1. Djalë ose vajzë dhanun mbas qejfeve, veseve, i ri i prapë; bandill; epshuer endacak; haram, lanok (Bash.). Nget poshtë e përpjetë, *çapkun* i madh. Mos u sjell me at *çapkun*, se të mëson rrugë të të këqija. Fëmi *çapkën*, lojçak që s'zë 'vend kurkund; "O bilbil e i paqënë — Nja dy djem, nja dy *çapkënë*, — Këndojnë në baçe tënë, — (Labëri). "Me të gjitha shoqet. — bashkuar ti jeshe. — Ty të njohu *çapkëni* — (Përmet). 2. *Çapkenkë-a* f. adj. Jugë: vashë ose grue çapkëne. " . . . e cila ish një vajzë rrumbullake dhe *çapkenkë*, që dukej sikur ishte djalë . . ." (D.K. 135, Noli). 3. *Çapkënllëk, çapkunllëk-u* m. (tur. *çapkinllik*): sjellje çapkëni, veprim i çapkunit. " . . . se e dinte që ish aq i urtë dhe aq armik i çdo *çapkënllëku* sa që . . ." (D.K. 94, Noli).

Sekr. çavkun, çapkun, çapkunluk, çapkunjenje dhe çapkuniti, vb. (Bakot., Esih); rum. coapein (Lok.)

çapkëne - ja f. rreth i Korçës, Devoll: anteri e qëndisun me mangë të varuna përmbra; it. specie di veste corte con maniche aperte. / Në turkisht ç a p k ë n (në të saktën *çapkân*), një lloj veshje shtati e shkurtë, e qëndisun, me mangë të çame, që të shumten varen për mbrapa (Sami 506).

çapllaxhi - u m. Cudhi, Malsi e Krues: grabitqar, që merr ç'të gjejë (T. D.). Këtë fjalë e ka dhe fjalori shqip. it. i Cord. 284 (marrë në Kurbin) "parassita, scroccone" Cfr. dhe ç a p è l - i m te Bashkimi e te Buseti 187 "venditore di cavalli; cavallerizzo" (=shites kuajsh, kalorës). *Çapeli* (=Cin) em. familje në Shk. Në turkisht ç a p ù l, ç a p a - ù l (ralik. ç a p, paskajori ç a p m à k "me nga, me dalë për inkursion: me nxitë kalin në ngamje"); ushtar kalorës inkursioni; ushtar sulmues për plaçkitje në tokë t'anmikut; fr. ancienne troupe légère pour opérer des razzias sur le sol ennemi (Sami 493). C a p u l l x h i "kalorës paraprisë, prarendës që msysen befaz anmikun për të plaçkitë e grabitë çka të gjejë" (Sami, po aty). Germ. Streifzug in Feindesland" (Mik.).

Pol. czambul "Einfall; Galopp" (Lok.)

çapraçik adv. katunde të Tiranës: përzimas, mikst.: n'at dasëm të thëritmit qenë *çapraçik*, malokë e katundarë në një kthinë të shkar-tisun. Në tur. *ç a p r a s h i k* (folja *çaprashmàk*): "kryqzuem, ngërthy-em" (Sami 493).

çapràk - u m. e ka Cord. shqip-it. 10 për Kelmend: "ornamento alle spalle delle donne". Në tur. *ç a p r à k* "mbulesë e shalës" (Sami 493). Kuptimisht efr. dhe *çapraz* (v. ma poshtë).

çaprashitë ft. 1. Te Bashkimi e te Cord. (shqip-it. 19) "dimenare i piedi". Ke Busetti "me përhjedhë, me luejtë andej e këndej". Ke Leoti 74 *ç a p r a s h i s* "mettere i piedi storti camminare storto". Prap ke Cord. (dagli "scrittori" 284) "confondere, disordinare, agitare, turbare; zappare per la seconda volta". Në Fj. gj. shq. 62, *ç a p r a s h i t* ft. "ngatroj": i *çaprashit* hesapet; ngatroj këmbët; mos *çapra-shit* ashtu, mos ecë shtrembër duke ngatërruar këmbët, flas kot, bluaj: mos *çaprashit*. Si u tha ma sipër (v. *çapraçik*), *ç a p r a s h m a k* në turkisht do të thotë: "me u kryqzue, me u ngërthye, me gërshetue". 2. Në toskënishten *çaprashit* edhe: flas çapraz, pa kuptue se ç'po thom. Mos të jetë edhe këtu një folje derivate e sajueme nga *çapraz*?

